

---

**OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA SH.A**

**Data 23.04.2026**

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** Blerje oksigjen për Spitalin Rajonal Vlorë me afat të marrëveshjes kuadër deri në 12 muaj me fond limit 6,884,352 (gjashtë milion e tetëqind e tetëdhjetë e katër mijë e treqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP)**

Oksigjen-24111900-4

Blerje oksigjen për Spitalin Rajonal Vlorë me afat të marrëveshjes kuadër deri në 12 muaj me fond limit 6,884,352 (gjashtë milion e tetëqind e tetëdhjetë e katër mijë e treqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **BLERJE OKSIGJEN PËR SPITALIN RAJONAL VLORE**

### **Shtojca 8**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### **FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

#### **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

##### **OFERTUESI DEKLARON SE:**

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9**

## *b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:** Licencë e lëshuar nga QKB për tregtimin me shumicë të barnave.

**Argumentimi:** Ky kriter vihet pasi për tregtimin e barnave në RSH, legjislacioni në fuqi parashikon detyrimin e pajisjes së subjektit që ushtron këtë aktivitet, me licencën përkatëse nga Qendra Kombëtare e Licencimit/ Biznesit.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se:“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39% i vlerës së fondit limit që prokurohet, është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 19% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a.Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose faturat tatimore

të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b.Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

### 2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të deklarojë origjinën e mallrave, kompaninë prodhuese/MAH.

**Argumentimi:** Kjo kerkese vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion. Ky kriter është në përputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dhe keto kerkese i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës pra të garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi.

### 2.3.3 Për barnat (objekt prokurimi) të autorizuar për tregtim në Republikën e Shqipërisë, duhet të paraqitet:

-dokumenti i cili konfirmon se bari i ofertuar, është i pajisur me autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

/ose/

-autorizimi për tregtimin e barit, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, brenda afatit të tij të vlefshmërisë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë Autorizim për tregtim të artikujt objekt prokurimi, që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/ shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente dhe që vlerësohet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës, gjithashtu siguria e pacientit barnat pa autorizim nuk janë kontrolluar për siguri, cilësi dhe efikasitet sipas standardeve shqiptare,garanton që pacientët të marrin barna të certifikuara dhe të testuara, duke respektuar protokollat mjekësore,autorizimi për tregtim është provë se barnat plotësojnë standardet e cilësisë farmaceutike të vendosura nga AKBMP.

Kërkesa e dokumentit siguron që oferta nuk përmban barna të falsifikuara, të skaduara ose jo të certifikuara.

**2.3.4** Operatori Ekonomik duhet të paraqesi autorizim të vlefshëm të lëshuar nga MAH (mbajtësi i autorizimit të tregtimit) nepermjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tij në vendin tonë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikat 2 dhe 4 të nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 5 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku është e cituar:”kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/entikontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor. Autorizimi për OE ofertues nga firma prodhuese është një dokument i domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente dhe që vlerësohet nga ana e njësisë së prokurimit si e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të paraqesi deklaratë që siguron, në rast avarie të tankerit të oksigjenit lëng, furnizimin me tanker rezerve ose me bombola oksigjeni mjekësor gaz, në rampat e oksigjenit të gaztë, për të siguruar gadishmerinë e furnizimit me oksigjen të shërbimeve spitalore 24/24 sipas nevojave të AK.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë vazhdimësinë e pandërprerë të furnizimit me oksigjen mjekësor, një element jetik për funksionimin normal të shërbimeve spitalore 24 orë në ditë. Duke qenë se oksigjeni mjekësor është produkt kritik për jetën e pacienteve, çdo ndërprerje për shkak të defekteve teknike, avarive apo mungesës së kapacitetit logjistik do të sillte pasoja serioze për sigurinë e pacienteve dhe funksionimin e spitaleve. Për këtë arsye, operatori ekonomik duhet të deklarojë angazhimin e tij për të siguruar sistem rezerve furnizimi, nëpërmjet tankerit alternativ ose bombolave të oksigjenit, në mënyrë që AK të ketë garanci të plote për cilësinë dhe besueshmërinë e shërbimit gjatë gjithë periudhës së kontratës.

Ky kriter është në përputhje me parimin e sigurisë së furnizimit dhe me legjislacionin teknik në fuqi që rregullon furnizimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e oksigjenit mjekësor në institucionet shëndetësore.

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se bombolat e oksigjenit, që do të furnizohen prej tij, plotësojnë kushtet teknike të pajisjeve nën presion. Për këtë duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar, nga organet kompetente kombëtare për regjistrimin, kontrollin e kushteve teknike dhe të sigurisë, për enët nën presion tankera/serbatore/cisterna, konform legjislacionit në fuqi, ku të jenë përcaktuar numri dhe kapaciteti i tyre, data e kontrollit, organi inspektues dhe plotesimi i standarteve, kushteve teknike dhe të sigurisë.

**Argumentimi:** Ky kriter vihet në përputhje me nenin 40 pika 6/c të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, sipas të cilit mund të kërkohen dëshmi për realizimin e testeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuar që vërtetojnë pajtueshmërinë e

produketeve me specifikimet teknike dhe eshte ne perputhje me objektin e kontrates. Është patur parasysh se oksigjeni i gaztë për përdorim mjekësor, mund të tregtohet i ambalazhuar me bombola, të cilat duhet të plotësojnë kushtet e sigurisë konform legjislacionit për enët nën presion.

**2.3.7** Certifikate ISO 9001-2015 ose ekuivalent, të vlefshme, për distribucionin e gazrave mjekësore, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020”Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilen gjejme te percaktuar se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nganjë organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje ne piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”ku percaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur.

**2.3.8** Certifikate ISO 45001-2018 45001-2023 ose ( certificate ekuivalente)/ ose ekuivalent..Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020”Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilen gjejme te percaktuar se:

Standarti ISO 45001 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” është vendosur si kriter me qëllim që AK të sigurohet që ofertuesi kryen aktivitetin në përputhje me standartet e kërkuara sa i takon shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe me qëllim parandalimin/shmangien e çfarëdo rreziku. Për një furnitor, të jetë i certifikuar ISO 45001 tregon angazhimin ndaj sigurisë dhe mirëqenies së punonjësve, që përkthehet në një reputacion më të mirë në treg dhe rrit besueshmërinë tek klientët.

**2.3.9** Certifikatë ISO 14001:2015 –Sistemi i menaxhimit mjedisor ose ekuivalent, të vlefshme, për distribucionin e gazrave mjekësore, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020”Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilen gjejme te percaktuar se:

AK Vlerëson të nevojshëm certifikimin e subjekteve ofertues me ISO 14001 ose ekuivalent, me qëllim garantimin se OE gëzon konfirmimet e nevojshme nga organizmi i vlerësimit të konformitetit, se ka ndërmarë masa proaktive me qëllim minimizimin e ndikimit negativ në mjedis, si dhe zbaton kuadrin rregullator përkatës në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Argumentimi i Specifikimeve Teknike Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Ne hartimin e secifikimeve teknike eshte pasur ne konsiderate:

- 1.Natyra e mallrave që do të prokurohen,
- 2.kushtet e perdorimit te tyre ne institucionet perkatese,
- 3 kerkesat per siguri, cilesi dhe qendrueshmeri.

-Specifikimet teknike synojne te garantojne realizimin e nje procedure prokurimi transparente, efektive dhe te barabarte, duke mundesuar blerjen e produkteve qe permbushin kerkesat teknike dhe funksionale te AK dhe qe garantojne perdorim te sigurtm cilesor dhe afatgjatë.

-Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfitues, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

## **NJËSIA E PROKURIMIT**